


# 4 KËMBËSHAT që ndryshojnë jetën tuaj

një udhëzues për adoptimin  
dhe bashkëjetesën korrekte me  
qentë dhe macet



LAV

DALLA PARTE  
DEGLI ANIMALI




Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve  
Animal Rights Foundation  
Fondacija za prava životinja

## Tekstet e redaktuara nga

Zyra e Marrëdhënieve Institucionale  
Ilaria Innocenti - LAV  
Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve

Grafika nga Angelo Orsini



## HYRJE


Zgjedhja për të jetuar me një mace apo qen është padyshim një akt i madh dashurie dhe sjell gëzim çdo ditë. Lehtëson marrëdhëniet shoqërore dhe ka një funksion pozitiv në relaksim dhe lehtësim të stresit.

Në të njëjtën kohë është edhe diçka që e ndryshon thellësisht jetën në thelbin e saj të përditshëm; për këtë arsye është një zgjedhje që duhet bërë me përgjegjësi dhe me vetëdije për të bërë një angazhim të madh, krejtësisht të ngjashëm me detyrat që prindi ka ndaj fëmijës.


Qentë dhe macet nuk janë kafshë shtëpiake, ato janë kafshë shoqëruese dhe nëse i mirëprisni në shtëpinë tuaj, ata do të bëhen anëtarë të plotë të familjes. Mes jush do të krijohet një marrëdhënie e bazuar në shkëmbimin e emocioneve dhe përvojave: do të mund të mësoni prej tyre dhe ata nga ju.

Ky udhëzues u krijua me qëllim që të ofrojë një mjet të dobishëm si për ata që duan të adoptojnë një mik me katër këmbë ashtu edhe për ata që tashmë jetojnë me ta. Së bashku do të bëjmë një udhëtim të vogël, gjatë të cilit do të zbulojmë se si të sillemi në mënyrën më të mirë, në mënyrë që bashkëjetesa me kafshët tona të jetë paqësore.

Lexim të këndshëm.



# TË ADOPTOSH një qen apo mace



## PSE TË ADOPTOSH

Kafshët janë qenie të gjalla që na kërkojnë vetëm një gjë: të jenë të dashur. Ato nuk janë objekte, madje as mallra që shkëmbehen. Nëse duam të zgjerojmë familjen tonë, duhet të udhëhiqemi nga të vetmet gjëra që kanë vërtet rëndësi: dashuria dhe ndjenja e përgjegjësisë.

Arsyja për adoptim ka të bëjë me faktin që ka mbi 20 mijë qen dhe mace endacake në Kosovë dhe zgjedhja e adoptimit është me të vërtetë opcioni i vetëm i zbatueshëm.

Jo vetëm sepse do t'i japim një shans të dytë një kafshe që e meriton, por edhe sepse do të marrim një veprim konkret për të luftuar situatën me qentë endacakë dhe trafikimin e paligjshëm të këlyshëve në Europë.

## QEN TË RRITUR APO KËLYSH?

Duke u endur nëpër strehimore, do të gjeni qen të të gjitha racave dhe madhësive. Raca e përzier. Këlyshë dhe qen të rritur.

Thamë se është zemra dhe ndjenja e përgjegjësisë që duhet të na drejtojë dhe jo një zgjedhje estetike. Megjithatë, ne e dimë se shumica e njerëzve duan të adoptojnë një këlysh. Është një zgjedhje me më shumë përgjegjësi, pasi këlyshët kërkojnë vëmendje dhe kujdes që shumë shpesh një qen apo mace e rritur nuk e kërkon. Këlyshët janë gjithashtu më lehtë të adoptueshëm.

Nëse jeni vërtet të udhëhequr nga ndjenja e përgjegjësisë dhe e zembrës, konsideroni gjithashtu të adoptoni një qen ose mace të rritur. Ai është më i predispozuar të mbështetet në udhëzime të qeta dhe të vendosura dhe do të ketë një mirënjohje unike ndaj jush, për shkak të kujtimit të traumave të kaluara. Për të do të jeni një shoqëruar dhe një shpëtimtar i pazëvendësueshëm.

## DUA TË ADOPTOJ

Pasi të shkoni në strehimore, përveç zembrës, kërkoni udhëzime nga një prej vullnetarëve ose një trajneri të qenve. Ata do të jenë në gjendje t'ju këshillojnë se cila kafshë mund të ndërveprojë më mirë me ju dhe familjen tuaj. Disa njerëz tërhiqen nga entuziazmi i momentit ose nga pamja e kafshës, pastaj kuptojnë se nuk mund ta menaxhojnë atë dhe e lënë pas dore ose më keq, e kthejnë në strehimore pas një kohe: për kafshën është një tjetër traumë dhe dhimbje torturuese.

Vetëm kur të jeni vërtet të sigurt, nënshkruani dokumentet e adoptimit dhe filloni një jetë të re.


# TË JETOSH me një qen apo mace

Në shtëpi - Trajnimi dhe mirëqenia



## MIRËSEVJEN NË SHTËPI

Shtëpia juaj do të bëhet gjithashtu shtëpia e mikut tuaj të ri katërkëmbësh. Një vend i rehatshëm për të fjetur, enë për ushqim dhe ujë dhe disa lodra do ta bëjnë atë të ndihet i mirëpritur menjëherë. Pjesa tjetër varet nga ju.



## QENI

Kujdesi dhe trajnimi i një qeni kërkon këmbëngulje, durim dhe respekt për disa rregulla të vogla themelore që do ta bëjnë bashkëjetesën tuaj të këndshme dhe argëtuese.

- Vendoseni shtratin ose siguron një hapësirë për të në një vend të qetë brenda shtëpisë, larg derës së përparme, por jo të izoluar; shmangni zonat e kalimit, të cilat nuk nxisin rehatinë. Mos e shqetësoni qenin dhe mos lejoni që të tjerët ta shqetësojnë kur ai është duke pushuar
- Mësojeni qenin të qëndrojë në vendin e dedikuar për të duke e lavdëruar dhe shpërblyer fillimisht sa herë që shtrihet. Shmangni dërgimin e tij si dënim përndryshe ai do ta shoqërojë atë me diçka negative
- Vendosni orarin e ushqyerjes dhe ushqejeni qenin rregullisht. Mos ia lini ushqimin në dispozicion gjatë gjithë kohës. Në vend të kësaj, lini gjithmonë ujë të freskët dhe të pastër në dispozicion të tij
- Mësoni atë me tinguj, aroma dhe situata të ndryshme (vetura, trafik, biçikleta, fshesa elektrike, tharëse flokësh, etj.), duke ulur gradualisht distancat dhe duke rritur gradualisht intensitetin, duke e shpërblyer nëse qëndron i qetë përballë këtyre stimuljeve të rinj
- Shmangni lojërat që e emocionojnë së tepërmi. Luani me të për të ndërtuar një marrëdhënie të ekuilibruar të bazuar në besim: mos harroni se çdo qen luan ndryshe bazuar në karakteristikat dhe moshën e tij. Përdorni lodra të bëra me materiale jo toksike dhe të vështira për t'u shkatërruar, pa pjesë të vogla që mund të gëlltiten
- Shëtisni qenin çdo ditë, duke u përpjekur të respektoni orarin e njejtë, edhe nëse keni një kopsht: ai do të lidhet me botën e jashtme dhe do të ndajë përvoja të këndshme me ju. Nëse qeni ka ardhur së fundmi në shtëpinë tuaj, bëni disa shëtitje që nuk janë shumë të gjata. Kushtoni vëmendje çdo gjëje që e tërheq dhe çfarë gëlltit, materiet helmuese janë një rrezik real dhe mund të jenë vdekjeprurëse.
- Edukoni me butësi: shpërblyeni dhe lavdëroni sjelljet pozitive të qenit, shmangni ndëshkimet fizike dhe të bërtiturat, ato janë të padobishme dhe shkatërrojnë marrëdhënien tuaj me qenin. Tërhiqni vëmendjen e qenit tek ju kur vini re se diçka e bën nervoz ose e shqetëson
- Mos e lini vetëm në kopsht për shumë orë (nëse është këlysh, kurrë) dhe sigurohuni që ai të mos shohë vazhdimisht njerëzit që kalojnë.

- Asnjëherë mos përdorni qafore elektrike ose me thumba, pasi që janë të ndaluara. Shmangni qaforet e ngushta dhe mos e mbani qenin tuaj të lidhur në zinxhir
- Asnjëherë mos e lini qenin vetëm në makinë. Edhe nëse temperatura e jashtme nuk është veçanërisht e lartë, makina është vetëm pjesërisht në diell dhe dritarja është pak e hapur, pjesa e brendshme e makinës mund të nxehet shpejtë
- Dërgojeni rregullisht te veterineri, duke e kombinuar vizitën me një shëtitje ose një aktivitet të këndshëm
- Mos i nënvlerësoni sjelljet si kafshimi ose hungërima, fenomenet e agresivitetit ndaj njerëzve dhe kafshëve të tjera, frika e tepruar: kontaktoni një ekspert ose trajner të sjelljeve të qenve.



## VE TËM NË SH TËPI

Mësoni qenin të qëndrojë vetëm në shtëpi gradualisht dhe për periudha kohore gjithnjë e më të gjata; mund të filloni thjesht duke e mbyllur veten në një dhomë për disa minuta, dhe duke e shpërblyer qenin nëse qëndron i qetë.

Kur dilni nga shtëpia, lini diçka për qenin të cilën mund ta kafshojë që të mos mërzitet, shmangni lamtumirat e gjata dhe festat e tepërta. Nëse ai leh ose ankohet kur të ktheheni, mos i kushtoni vëmendje, lëvdojeni sapo të qetësohet. Mos lini kimikate ose medikamente të cilat qeni mund t'i arrijë.

Nëse pavarësisht masave dhe përpjekjeve tuaja situata nuk përmirësohet, kërkoni këshilla nga veterineri juaj i besuar.



## KOMUNIKIMI

Ndërsa ne komunikojmë kryesisht verbalisht, qeni përdor kryesisht kanalin kimik - nuhatës. Qentë përdorin gjithashtu gjuhën e trupit për komunikim, përmes një repertori të gjerë qëndrimesh të trupit. Për të kompletuar komunikimin kompleks të qenit, përfshihet edhe komunikimi vokal, i cili shprehet përmes një sërë tingujsh pak a shumë të artikuluar, të cilët ndryshojnë në ton, intensitet dhe kohëzgjatje.

Kuptimi i mënyrave të komunikimit të qenve do t'ju lejojë të shmangni gabimet e zakonshme dhe të jetoni në një marrëdhënie të kënaqshme për të dy.

## KOMUNIKIMI ME NUHATJE

### Nuhatja


Me hundën e tij, qeni mbledh informacione për botën rreth tij: njeh kalimin e kafshëve të tjera dhe interpreton mesazhet e lëna në territor. Komunikimi përmes nuhatjes është gjithashtu një sistem njohjeje midis qenve: në momentin e takimit nuhaten zona gjenitale, anale dhe veshi, duke mbledhur kështu një sërë informacionesh të rëndësishme për individin tjetër.

### Markimi

Qeni komunikon me qentë e tjerë edhe pa kontakt të drejtpërdrejtë, nëpërmjet nevojës dhe duke lënë aromën e tij, duke u gërvishur, rrokullisur ose duke u fërkuar. Markimi është një mesazh që i lihet qenve tjerë dhe nuk tregon domosdoshmërisht qëllimin për të markuar territorin e qenve tjerë.

## GJUHA E TRUPIT



Gjuha e trupit është shumë komplekse; Nuk kemi ndërmend t'ju lodhim, por më poshtë ju propozojmë disa nga qëndrimet më të zakonshme. Njohja e tyre do t'ju ndihmojë të interpretoni gjendjen emocionale dhe synimet e qenit tuaj dhe qenve të tjerë.




### QEN I LUMTUR, I RELAKSUAR

Qëndrim i qetë, gëzof i butë, goja pak e hapur, veshët në pozicion natyral, tundje e lehtë e bishtit


Të pasmet e ngritura, gëzofi i butë, bishti i ngritur lartë dhe tundje e lehtë, veshët në pozicion natyral, lehje e mundshme. Ky pozicion njihet si "përkulja e lojës" dhe përdoret nga qentë si me llojin e tyre ashtu edhe me speciet e tjera. Ndonjëherë qentë meshkuj e përdorin edhe me qentë femra për të cilat janë të interesuar



Pesha e qenit shpërndahet në mënyrë të barabartë në të katër këmbët, gëzof i butë, gojë e hapur dhe e relaksuar, shprehje e interesimit, kurioz



Trupi i ulur, koka e ulur, bishti midis këmbëve, veshët të tërhequr prapa, hapja e madhe e gojës



Shtrirë, shmang kontaktin me sy ose kthen kokën për të shmangur shikimin, lëpin hundën dhe veshët shtyhen prapa

Ulur, veshët mbrapa, bishti midis këmbëve të pasme. Shmang kontaktin me sy, hap gojën, njëra putër e përparme mund të jetë pak e ngritur




### QEN I BRENGOSUR

Këto qëndrime tregojnë se qeni është në një situatë të pakëndshme dhe nuk dëshiron t'i afrohet askush.

## ● QEN I INATOSUR OSE NË SHQETËSIM TË MADH


Një qen me këto qëndrime kërkon që individi të qëndrojë larg ose të largohet.

Kini kujdes, mos u largoni kurrë prej tij, duke ja kthyer shpinën, lëvizni prapa ngadalë me lëvizje të konstante pa e shikuar direkt, por duke mbetur përballë tij.



Këmbët e ngurtësuar, trupi pak i ngritur përpara, veshët e nxjerrë përpara, qimet e ngritura; bishti është i lartë dhe i ngurtë, bebëzat janë të zgjeruara dhe shikimi i drejtuar nga individi që ka afër

I shtrirë dhe duke treguar dhëmbët, veshët e tij janë rrafshuar, bishti i tij midis putrave



Trupi i ulur dhe i përkulur mbrapa, koka e përkulur përpara, vështrimi i fiksuar tek personi që ka afër, hunda e rrudhur, buzët e mbledhura dhe dhëmbët të dukshëm, veshët e vendosur poshtë dhe mbrapa, hungërimë



## KOMUNIKIMI VOKAL

Siç thamë më parë, qeni komunikon përmes sinjaleve të ndryshme vokale. Këtu janë disa:

### LEHJA

Shpreh një gjendje eksitimi dhe përdoret për qëllime të ndryshme, si mbrojtja e territorit, sinjalizimi dhe identifikimi i hyrjeve në territor, situatat e alarmit, kërkesa për vëmendje në situatat e lojërave ose në gjendje stresi.

### BËRTIMA

Tregon dhimbje ose frikë, nëse është e papritur me një ton të lartë dhe të thatë mund të tregojë se qeni ka dhimbje.

### RËNKIMI

Rënkimet e shkurtra shpesh janë shenjë frike ose ankthi; një rënkim i vazhdueshëm, me zë të lartë mund të jetë një thirrje për vëmendje, të


pasqyrojë ankth të fortë ose të tregojë siklet ose dhimbje të forta.

### HUNGËRIMA

Tregon që qeni është nervoz ose ndihet i kërcënuar: këshillohet të largoheni pa e shikuar në sy. Një hungërimë e lehtë gjatë lojës duhet të vlerësohet sipas kontekstit dhe pozicionit të përgjithshëm të qenit.

### ULËRITJA

Është thirrja e grupit; një ulërimë e gjatë dhe e qëndrueshme tregon ndarjen nga grupi ose vetminë. Një ulërimë e shkurtër e zërit në rritje në përgjithësi tregon se qeni është i lumtur ose i emocionuar.



## LOJA

Shpesh aktiviteti i lojës që i ofrohet qenit tuaj konsiston vetëm në lojën për orë të tëra duke hedhur një top, një kafshë lodër e butë, ose një copë druri. Besimi më i përhapur është se në këtë mënyrë qeni lodhet shumë dhe më pas qëndron i qetë në shtëpi. Megjithatë, ndjekja, kapja dhe kthimi/shkatërrimi/sjellja e një objekti të tillë si një top në një vend të sigurt janë fazat e sekuencës grabitqare që, në natyrë, një grabitqar zbaton për të marrë ushqim. Pra, kur qeni juaj shkon pas asaj që i hodhët, gjithçka që ai bën është të përpqet të arrijë dhe të ndalojë prenë. Prandaj është një aktivitet shumë emocionues, jo qetësues. Loja, veçanërisht loja e përbashkët, është një aspekt themelor i jetës së një kafshe si qeni dhe, nëse përdoret në mënyrën e duhur,

mund të përfaqësojë një terren të vërtetë trajnimi për jetën, si dhe një mundësi për të forcuar lidhjet shoqërore. Kjo është arsyeja pse nëse vërtet dëshironi që qeni juaj të jetë i lumtur dhe i ekuilibruar, duhet të investoni kohë për ta njohur me të vërtetë dhe të reflektoni, për shembull, mbi faktin se shqisa e tij më e zhvilluar është shqisa e nuhatjes. Pra, pse të mos filloni nga kjo për t'i ofruar atij lojëra interesante dhe të kënaqshme për t'u argëtuar së bashku? Lojërat e bazuara në nuhatje janë të përshtatshme për të gjithë qentë, sepse ato nxisin përqendrimin dhe i lodhin mendërisht, prandaj janë të dobishme për qentë shumë të shqetësuar dhe vazhdimisht në lëvizje; ato rrisin vetëbesimin dhe aftësinë për zgjidhjen e problemeve, prandaj janë të përshtatshme për qentë e turpshëm dhe të pasigurt; në shumë raste ato përfshijnë përdorimin e kafshatave të shijshme të ushqimit, duke lejuar kështu përfshirjen edhe të qenve që nuk janë shumë të interesuar për objektet ose janë apatikë.

*Nga Alessandra Ferrari*



## GABIMET QË NUK DUHET T'I BËNI

Është shumë e rëndësishme të mos adoptoni sjellje që, përveçse nuk mësojnë asgjë, rezultojnë kundërproduktive dhe në disa raste të rrezikshme, si p.sh.:

- ndëshkimi i qenit kur të ktheheni në shtëpi dhe kur konstatohet dëmi i shkaktuar nga qeni. Qeni nuk është në gjendje të lidhë dënimin me veprimin që ka kryer shumë kohë më parë
- ndëshkimi i qenit kur pasi e keni thirrur për një kohë të gjatë, ai kthehet tek ju. Në këtë rast ai do ta ndërlidhë dënimin me veprimin tuaj të fundit "kthimi te ti" dhe jo me atë të mëparshëm "mospërgjigjja ndaj thirrjes". Kthimi tek ju duhet të jetë gjithmonë një përvojë e këndshme
- duke e shqetësuar kur ha ose fle, ai mund të reagojë
- përdorni sinjale bazuar në kuptimin që u atribuojmë atyre, pa u shqetësuar se çfarë mund të nënkuptojnë për qenin. Për shembull, për ne një përqafim është një demonstrim dashurie, ky nuk është rasti për qenin, i cili mund ta interpretojë atë si një provë force ose si një përpjekje për ta kufizuar dhe të reagojë.
- ndëshkimi i qenit gjatë trajnimit për higjienën në shtëpi: ndëshkimi fizik, qortimi, futja e fytyrës së qenushit në urinë ose jashtëqitje është krejtësisht e padobishme. Injoroheni qenin kur ndot shtëpinë dhe pastroni kur qeni nuk është prezent, shpërbleni dhe lavdëroni qenin shumë kur kryen nevojat jashtë, në këtë mënyrë ai do të kuptojë se çfarë prisni prej tij.





## TRAJNIMI I QENIT

Qeni mëson në çdo moshë. Ai mëson nga përvojat pozitive dhe negative. Ai mëson më mirë nëse keni durim dhe nëse e shpërbleni kur bën sjelljet e duhura.

Edhe kur ka mësuar një sjellje, herë pas here duhet të shpërblehet nëse e shfaq: në këtë mënyrë do ta përforcojë atë sjellje.

Për trajnimin e qenit, kryefjala është qëndrueshmëria, kështu që e gjithë familja duhet të sillen në të njëjtën mënyrë me të. Mos i jepni sinjale kontradiktore dhe përdorni gjithmonë të njëjtat fjalë ose shenja kur i kërkonit të bëjë një gjë të caktuar, përndryshe do të hutohet.

Qëndrueshmëria do të thotë gjithashtu të mos e lejoni të silltet mirë vetëm në raste të caktuara: për shembull, të kërcejë mbi ju kur jeni të veshur me tuta, por jo kur keni veshje elegante. Qeni nuk mund të bëjë dallimin.

Gjithmonë shpërbleni të gjitha sjelljet korrekte me përkëdhelje, shpërblime vokale dhe mos e teproni me ushqime: delikatesat janë të mira në fazën e parë të trajnimit, pastaj duhet të ndërrohen me shpërblime tjera.


Sigurisht që nuk duam kurrë, por ndonjëherë duhet ta bëjmë të kuptojë se nuk është sjellë mirë. Ndëshkimet fizike janë të kota, me një zë të qetë dhe të vendosur ose duke e drejtuar butësisht mund ta bëni të kuptojë se cilat janë qëndrimet e gabuara, kjo është mënyra më e mirë për ta edukuar, e vetmja mënyrë që nuk do të komprometojë marrëdhënien tuaj, sepse për të qenë të lumtur së bashku, ai nuk duhet të ketë frikë nga ju, por duhet të ketë besim.

Duhet të mbajmë gjithmonë në mend dy gjëra thelbësore: ndëshkimi apo shpërblimi duhet të ndodhin menjëherë pas sjelljes që duam të korrigojmë ose inkurajojmë dhe sa herë që dekurajojmë një sjellje duhet të tregojmë një të drejtë dhe nëse qeni e kryen sjelljen e duhur, ta shpërblejmë me një përkëdhelje ose duke e ftuar për lojë.

## Qentë dhe fëmijët

Asnjëherë mos i lini vetëm qentë dhe fëmijët. Mbikëqyrja juaj është thelbësore. Kini kujdes që fëmija të mos hidhet papritur mbi qenin dhe mësoni fëmijën të mos prekë qenin në pjesë të ndjeshme, të mos e shqetësojë kur ha apo pushon dhe kur ndërvepron me kafshë të tjera.

Nëse qeni lëshon shfaq vazhdimisht sinjale të qeta në prani të fëmijëve, dhe nëse vëreni shenja stresi si ikja kur fëmija vjen, tentativa për të ikur, ulërima, konsultohuni menjëherë me veterinerin tuaj.



## MACJA



- Edhe pse konsiderohet një kafshë më e pavarur se qeni, macja gjithashtu kërkon kujdes dhe vëmendje të veçantë
- Siguroni një kuti për nevoja për macen, në një vend të izoluar dhe larg enëve të ushqimit dhe ujit. Pastrojeni të paktën një herë në ditë, maceve nuk u pëlqen të përdorin kuti të pista për të kryer nevojat
- Ushqeni macen disa herë në ditë dhe me temperaturë të dhomës. Mbani gjithmonë në dispozicion të maces të paktën dy enë: një për ujë dhe tjetrën për ushqim
- Caktoni zonat për lojë dhe pushim dhe qasje në një pikë të lartë nga ku macja mund të monitorojë rrethinën e saj
- Siguroni një vend ku macja mund të strehohet: një vend për t'u fshehur mund të jetë një kuti e thjeshtë kartoni
- Siguroni një shtyllë gërvishtëse, duke mos lejuar kështu që macja të shfryhet në kolltuqe ose perde
- Para se t'i lejoni qasjen në ambiente të jashtme, sigurohuni që të ketë kushte për sigurinë e saj dhe mbajeni macen në shtëpi mjaftueshëm gjatë sa të kuptojë se ky është territori i saj dhe se duhet të kthehet.
- Lërimi gjithmonë lodrat në dispozicion për macen dhe kushtoni asaj pak kohë çdo ditë. Megjithatë, keni kujdes: objektet e mprehta, shiritat dhe topat e lehtë mund të jenë të rrezikshme
- ralloni përkëdheljet gjatë ditës dhe mos i vazhdoni shumë gjatë, mos e përkëdhelni kundër dëshirës së saj. Ndaloni së përkëdheluri kur vëreni shenja të mosdurimit (bebëzat e zgjeruara, rrahja e bishtit, ngurtësimi i trupit, veshët prapa). Mos harroni, macet pëlqejnë ndërveprimet e shkurtra dhe në përgjithësi nuk u pëlqen të preken në bark, putra, sqetulla dhe bisht.
- Kushtoni vëmendje bimëve në shtëpi: lulet si poinsettia, rododendron, diffenbachia dhe oleander, për shembull, janë helmuese për macet, siç janë edhe për qentë.
- Asnjëherë mos përdorni helm kundër minjve, vrasës të insekteve ose plehra bimore: ato mund të jenë vdekjeprurëse për macen
- Dërgojeni macen rregullisht tek veterineri



## RESPEKTONI KOHËN E SAJ

Ndryshimi i mjedisit është shumë stresues për një mace, madje mund të duhen disa ditë ose javë para se të jetë në gjendje të pushojë në shtëpinë e saj të re. Sapo të mbërrini në shtëpi, do të duhet të jeni të durueshëm dhe të përpiqeni të fitoni menjëherë besimin e saj me një qëndrim të qetë. Lejojeni të eksplorojë mjedisin e ri.

Nëse macja është shumë e turpshme, ajo mund të fshihet. Në këtë rast, jepini asaj gjithë kohën që i duhet për t'u përshtatur, kur të ndihet e gatshme do të braktisë strehimin e saj. Nëse e thërrisni dhe nuk respektoni dëshirën e saj për të qëndruar larg, stresi i saj do të rritet dhe koha që do të kalojë duke u shoqëruar me ju do të jetë më e gjatë.




## KOMUNIKIMI

Macja gjithashtu ka gjuhën e saj të nuhatjes, të trupit dhe vokale. Është shumë e rëndësishme të kaloni kohë për të vëzhguar shprehjet e saj të fytyrës, qëndrimet e saj dhe duke dëgjuar vokalizimet e saj në situata të ndryshme, për të kuptuar se çfarë dëshiron të komunikojë macja.


### KOMUNIKIMI ME NUHATJE

Komunikimi nuhatës i maces ndodh kryesisht me fërkim të fytyrës, gërvishtje dhe markime përmes urinës. Të gjitha këto veprime shërbejnë për çlirimin e sekrecioneve aromatike, me të cilat macja jo vetëm kufizon dhe sinjalizon territorin e saj, por gjithashtu transferon aromën e saj edhe tek anëtarët e tjerë të grupit, një shenjë e vërtetë e përkatësisë në atë grup.




## GJUHA E TRUPIT

Macet përdorin pozicionet dhe lëvizjet e trupit për të na treguar se si ndihen. Këtu janë disa nga qëndrimet më të zakonshme të trupit dhe kuptimet e tyre.




Bishti lart dhe i relaksuar, veshët përpara, duke ecur drejt jush: macja e relaksuar dhe miqësore që tregon sjellje përshëndetëse



Fërkon bishtin, kokën dhe anën e trupit rreth këmbëve tuaja dhe ndonjëherë mund të rrokulliset në njërin anë për të treguar barkun: Macja e relaksuar dhe miqësore

Rrotullohet në njërin anë dhe ekspozon barkun: macja po komunikon se ndihet mjaft e qetë dhe e relaksuar në praninë tuaj për të ekspozuar një pjesë kaq të ndjeshme të trupit



Pozicioni i kërrusur me bishtin e vendosur nën trup dhe muskujt e tensionuar, sytë mund të skanojnë shpejt përreth, veshët janë mbrapa ose lëvizin për të kapur tinguj dhe zhurma: macja është në ankth dhe mund të kërkojë një vend për t'u fshehur, për të shpëtuar dhe për të kërkuar strehim në një vend të lartë



Shpina e lakuar, bishti dhe qimet e ngritura për t'u dukur më e madhe, bebëza të zgjeruara dhe veshë të rrafshuar me kokën, macja edhe fërshëllejë: macja shumë e frikësuar, e cila ndihet e kërcënuar ose që nuk mund të ikë.

Keni kujdes sepse ajo mund të sulmojë në për t'u mbrojtur. Sigurohuni që macja të ketë një rrugë për t'u larguar ose një vend ku mund të strehohet. Mos u afroni ose mos e prekni





## KOMUNIKIMI VOKAL

Macja bën shumë tinguj të ndryshëm, secili me një kuptim të saktë. Zhurma me vibrim është mënyra se si macja shpreh kënaqësinë, megjithatë, në disa raste, mund të jetë mënyra se si shpreh shqetësimin fizik ose frikën.

Ka edhe shumë forma të mjaullimit, nga ajo e shkurtër e përshëndetjes deri tek ajo e gjatë e kërkesës. Fërshëllima, megjithatë, tregon se macja dëshiron që të largohemi ose është shumë e frikësuar.



## TRAJNIMI I MACES

Marrëdhënia mes nesh dhe maces është një pakt i bazuar në besim. Ndëshkimi fizik dhe zhurmat e papritura janë mënyra më e mirë për ta bërë macen të largohet nga ju dhe si rrjedhojë kthimi i saj tek ju nuk do të jetë i lehtë. Nëse macja ka ndonjë sjellje të padëshiruar, përpiquni të kuptoni arsyen, ndonjëherë për ta korrigjuar ose ndaluar atë mjafton të ridrejtoni vëmendjen e saj drejt një loje.

Aktiviteti i lojës është shumë i rëndësishëm për macen, përmes tij mund t'i mësoni shumë gjëra maces tuaj. Për më tepër, falë lojës, me kalimin e kohës, macja do të rivendosë kontaktin e saj emocional me ju.

Mos harroni se edhe ndërprerja e lojës ka një vlerë pedagogjike dhe ju lejon të korrigjoni sjelljet si gërvishtja apo kafshimi.




## GABIMET QË NUK DUHET T'I BËNI

Mos harroni se macja është një shpirt i lirë dhe nuk i pëlqen kufizimet, por në të njëjtën kohë ajo ka nevojë për vëmendje dhe për t'u kuptuar.

Prandaj, të mos bëjmë gabime si:

- duke e ndëshkuar me spërkatje uji, britma, prekje në fytyrë, duartrokkitja vetëm sa do ta bëjë atë të humbasë besimin tek ju.
- duke e neglizhuar dhe duke e mërzitur. Dedikimi i kohës dhe vëmendjes ndaj maces, përfshirja e saj në aktivitetet e shtëpisë dhe loja me të, qoftë edhe për disa minuta disa herë në ditë, është thelbësore për zhvillimin dhe ruajtjen e një marrëdhënieje të mirë.
- interpretimi i disa nga sinjaleve të maces si ngacmim. Nëse macja nuk e përdor kutinë për kryerjen e nevojave, për shembull, mund të ketë shumë shkaqe, duke përfshirë një kuti që është e ndotur, shumë e vogël, e vendosur në një pjesë të shtëpisë që është shumë e ngarkuar ose e zhurmshme, një numër i pamjaftueshëm i kutive për nevoja nëse ka shumë mace, cystitis ose probleme të tjera të sistemit urinar
- mos respektimi i privatësisë së saj fizike duke e përkëdhelur dhe/ose duke e prekur kur ajo shfaq shenja të mos durimit ose kur largohet ose kur është duke fjetur
- ekspozimi i maces ndaj situatave, stimulje ose pranisë së njerëzve që ajo nuk i toleron, në këto raste macja ka nevojë për një vend të sigurt për t'u strehuar: sigurohuni që të ketë një vend të tillë.



## PËR SHËNDETIN E TYRE

### STERILIZIMI - QENTË DHE MACET



Siç thamë, vizitat periodike te veterineri janë thelbësore për mirëqenien e miqve tanë katërkëmbësh. Sigurohuni që t'i vaksinoni rregullisht dhe sigurohuni që të kenë mbrojtje adekuatë nga parazitët, si krimbat e zemrës dhe insektet si mushkonjat dhe mizat e rërës, veçanërisht gjatë verës.

Kur jemi te parandalimi, është me rëndësi të thuhet disa fjalë për sterilizimin e kafshëve. Tek femrat, sterilizimi ul ndjeshëm rrezikun e kancerit të gjirit dhe patologjive serioze që prekin sistemin riprodhues. Sterilizimi nuk ka pse të kryhet pas lindjes së parë, siç besojnë disa. Në të vërtetë, sa më shpejt ta parandaloni lindjen e këlyshëve, aq më mirë.

Tek meshkujt, operacioni është një masë paraprake e dobishme për kancerin e prostatës dhe dekurajon ikjet për qëllime të riprodhimit.

Sterilizimi i mbron macet nga infeksionet dhe sëmundjet si FIV (imunodeficiency, e krahasueshme me AIDS-in e njeriut) dhe FeLV (leukemia e maces).

E dimë që operacioni për sterilizim ka një kosto financiare, por duhet pasur parasysh se ai bëhet vetëm një herë dhe, duke qenë një parandalim i rëndësishëm, është edhe një kursim në krahasim me shpenzimet që duhen përballuar nëse shfaqen patologji që mund të shkaktojnë probleme tek qentë dhe macet e pasterilizuara.

Me dietën e duhur dhe aktivitetin e duhur fizik, kafshët nuk rrezikojnë të shtojnë as peshë.

Mos harroni gjithmonë se sterilizimi nuk është vetëm një ndërhyrje e sigurt që rrit ndjeshëm jetëgjatësinë e qenve dhe maceve, por është gjithashtu një mjet i vlefshëm në luftën kundër shtimit të numrit të kafshëve endacake.

# BASHKËJETESA sipas ligjit



## DETYRAT E MBAJTËSIT/PRONARIT

Legjislacioni i Republikës së Kosovës ka bazë ligjore e cila parasheh përkujdesjen ndaj kafshëve në mënyrë që të sigurohet plotësimi i nevojave fizike, fiziologjike dhe sociale të kafshëve. Sipas Ligjit për Përkujdesje ndaj Kafshëve, çdo person që mban apo kujdeset për çfarëdo kafshe, do të jetë përgjegjëse për sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e kafshës.



## IDENTIFIKIMI DHE REGJISTRIMI

Sipas Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) 02/2018 & 02/2021 për Identifikimin dhe Regjistrimin e Kafshëve Shoqëruese, pronari/mbajtësi ose personi i autorizuar për përkujdesje të kafshës shoqëruese, është i obliguar që ta bëjë identifikimin e kafshës me mikroçip brenda periudhës prej tre (3) muaj nga data e lindjes dhe të bëjë ndërlidhjen e të dhënave të kafshës me të dhënat personale të tij/saj. Legjislacioni në fuqi e ndalon braktisjen e kafshëve shoqëruese apo të vegjëlve të tyre sipas UA (02/2021) për ndryshim plotësimin e UA 02/2018 për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve shoqëruese. Ndryshimet në pronësi, vendbanim, humbje, vjedhje dhe vdekje duhet t'i komunikohen Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë apo tek veterineri, sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara me ligj. Kushdo që nuk e bën këtë mund të dënohet me gjobë. Identifikimi dhe regjistrimi i maceve është obligativ po ashtu. Po ashtu, është gjithmonë e detyrueshme në rastin e transferimit të kafshës për çfarëdo arsye, për udhëtim jashtë vendit dhe për hyrje në BE. Prandaj, është gjithmonë një ide e mirë për të identifikuar macen, pasi që mikroçipi është thelbësor në rast të humbjes.



## TRANSPORTI I KAFSHËVE SHOQËRUESE

Për të udhëzuar/lëvizur me kafshën tuaj shoqëruese brenda dhe jashtë Kosovës, duhet të ndiqen udhëzimet dhe dispozitat ligjore në fuqi, duke përfshirë edhe rregullat e destinacionit ku do të udhëtojë kafsha. Kafsha duhet të ketë të gjitha vaksinimet e nevojshme të përditësuara, duhet të jetë e identifikuar me mikroçip dhe duhet të posedojë të gjitha certifikatat mjekësore të aprovuara nga autoriteti kompetent.




## MBROJTJA NGA ABUZIMI

Kodi Penal i Republikës së Kosovës parasheh dënime me gjobë dhe/ose me burgim për këdo që me veprim apo mosveprim i shkakton kafshës vujtje, dhimbje apo shqetësime të rënda. Sipas Kodit Penal, organizimi i luftërave me qen po ashtu përbën veprë penale dhe është i ndaluar.

Në Kosovë, Ligji nr. 02/L-102 për mbrojtjen nga zhurmat nuk përmend zhurmat e shkaktuara nga kafshët. Zhurmat e shkaktuara nga kafshët nuk përmenden as në Ligjin për Përkujdesje ndaj Kafshëve, e as në Ligjin për Veterinarinë.

Megjithatë, Ligji për Mbrojtjen nga Zhurmat parasheh masa për parandalimin e zhurmave që shkaktojnë bezdisje në komunitet, si dhe masat parandaluese si izolimin për mbrojtje nga zhurma të ndërtesave apo banesave të cilat mund të jenë si burim i zhurmës, në hapësirat e punës ose banimit.



## QAFORJA DHE LITARI

Në Kosovë, obligimi për qafore dhe litar nuk përmendet në dispozitat ligjore, megjithatë, Ligji për Rendin dhe Qetësinë Publike e specifikon që kushdo që në vend publik mbanë ose ka shtazë pa mbikëqyrje ose pa mjetet e duhura mbrojtëse, dënohet për kundërvajtje.

Rregullat për transportin publik janë në diskrecion të Komunave, dhe deri më tani me asnjë rregullore komunale nuk është e rregulluar çështja e kafshëve shoqëruese në transport publik.



## MBLEDHJA E FECESAVE TË KAFSHËVE

Komunat janë përgjegjëse për draftimin e rregulloreve për rregullat specifike për parandalimin e ndotjes së mjedisit, dhe as në këtë rast, nuk ka ende asnjë akt nënligjor që përmend specifikisht ndotjen nga fecesat e kafshëve.



## TRAFIKU RRUGOR

Ligji për Rregullat e Trafikut rrugor nuk përmend specifikisht transportin e kafshëve shoqëruese, por më shumë koncentrohet në transportin e kafshëve shtëpiake.

Në rast të transportit të një numri më të madh të kafshëve, duhet të përdoren mjete të dedikuara për transportin e kafshëve, si dhe kafshët nuk guxojnë të vendosen në ulëset e përparme të makinës.



## UDHËTIMI JASHTË VENDIT

Për udhëtimin me kafshë shoqëruese, duhet të ndiqen paraprakisht disa rregulla për t'u siguruar që kafsha lejohet të hyjë në një nga vendet e BE-së.

Kafsha duhet të jetë e identifikuar me mikroçip dhe e vaksinuar kundër tërbimit, dhe e pajisur me pasaportë për kafshët shoqëruese. Një muaj pas dhënies së vaksinës kundër tërbimit, duhet të mirret mostra e gjakut dhe të dërgohet për testim në një laborator të licencuar dhe aprovuar nga BE. Nëse analizat e gjakut janë në rregull, qeni apo macja duhet të pres së paku 3 muaj para se të niset për BE.



Kafshët duhet të jenë së paku 7 muajshe para se të udhëtojnë në BE. Sepse siç dihet vaksina e tërbimit jepet jo më herët se 3 muaj të moshës së kafshës. O ditë para nisjes për BE, qentë apo macet duhet të bëjnë trajtimin kundër ekinokokut, dhe çdo gjë duhet të jetë e nënshkruar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë.

## KËSHILLA TË DOBISHME



### NË RAST TË HUMBJES - QENI


Mundësia e humbjes së kafshës është sigurisht diçka që na tmerron. Sidoqoftë, nëse do të ndodhte, është mirë të qëndroni të qetë dhe të bëni gjithçka që është e mundur për të gjetur mikun tuaj katërkëmbësh:

- raportoni menjëherë humbjen e kafshës në polici dhe tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
- publikoni një shpallje në rrjetet sociale dhe mbuloni lagjen ku jetoni (dhe lagjet tjera pranë) me postera sa më të detajuar, të plotësuar me foto të qenit dhe numër telefoni
- vendosni shpalljen edhe në bare, vende të ndryshme në publik, klinika veterinare: kudo
- Mos e kufizoni kërkimin tuaj në zonën e humbjes: qeni mund të udhëtojë shumë larg
- dërgoni shpalljen në radio dhe portale, si dhe kontaktoni shoqatat lokale për të drejtat e kafshëve dhe veterinerët
- shkoni personalisht nëpër strehimore

### NË RAST TË HUMBJES - MACJA

Ashtu si në rastin e humbjes së qenit, publikoni një shpallje në rrjetet sociale dhe mbuloni lagjen tuaj dhe zonat përreth me postera, vizitoni strehimoret dhe kërkoni nga radiot dhe portalet të shpërndajnë shpalljen për kërkimin e maces.

# NËSE HASNI në një qen apo mace në vështirësi



## SI TË NDIHMONI NJË QEN QË BREDH

Nëse hasni në një qen që bredh, ndaloni dhe afrohuni me kujdes dhe asnjëherë direkt.

Kontrolloni nëse qeni ka një etiketë (për mikroçip ju duhet një lexues i veçantë).

Nëse qeni nuk ka etiketë, është e rëndësishme të raportoni qenin në Polici apo në Agjenci të Ushqimit dhe Veterinarisë. Nëse qeni ndodhet në rrugë ose afër rrugës dhe mund të jetë rrezik për veten dhe të tjerët, dhe për të shmangur një aksident të mundshëm me vetura, është e nevojshme të telefononi menjëherë Policinë ose operatorin e kontraktuar nga Komuna juaj për trajtim të qenve endacakë.

## SI TË NDIHMONI NJË MACE QË BREDH

Procesi që duhet ndjekur është i ngjashëm me atë të gjetjes së një qeni, por është e nevojshme të konstatohet me kujdesin maksimal që macja me të vërtetë është e humbur ose e braktisur dhe nuk është anëtare e një kolonie macesh endacake ose thjesht ka dalë për shëtitje.

## SI TË NDIHMONI NJË KAFSHË SHOQËRUESE TË NGUJUAR

Nëse hasni në një kafshë shoqëruese të ngjuar në ndonjë vend, kontaktoni Zjarrfikësit në numrin 193.

## SI TË NDIHMONI NJË QEN OSE MACE TË LËNDUAR

Afrohuni te kafsha, nëse është e mundshme, me shumë kujdes dhe qetësi. Në mungesë të një numri specifik dhe publik të urgjencës për kafshët e lënduara, duhet të kontaktoni klinikën më të afërt veterinare, nëse kafsha nuk ka mbajtës/pronar. Sipas legjisllacionit në fuqi, shërbimet veterinare të kontraktuara me fonde publike duhet të jenë të disponueshme edhe gjatë natës dhe ditëve të festave.



Spänning  
Quintess

# 4 KËMBËSHAT që ndryshojnë jetën tuaj

një udhëzues për adoptimin dhe  
bashkëjetesën korrekte me  
qentë dhe macet



DALLA PARTE  
DEGLI ANIMALI



Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve  
Animal Rights Foundation  
Fondacija za prava životinja

Informohuni në

[www.animalrights-rks.org](http://www.animalrights-rks.org) dhe [www.lav.it](http://www.lav.it)